



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

KRYETARI

Nr. 1840 prot.

Vau Dejës, më 18.03.2021

VENDIM

NR 10 . Date 18/03/2021

**“PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE”**

Mbështetur në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; në zbatim të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar , neni 79, pika 1.

**VENDOSA:**

1. Të përcaktoj vendet publike në territorin e Bashkisë, për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendet e caktuara janë në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe kanë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore.
2. Konkretisht lejohet të afishohen materialet propagandistike në Postën Bushat, Posta Vau Dejës dhe Posta Mjedë, sipas planvendosjeve bashkëngjitur.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij Policia Bashkiake në bashkëpunimin me Policinë e Shtetit, që garantojnë zbatimin e përcaktimeve të bëra në këtë nen duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore në vendet jashtë përcaktimeve të bëra në pikat 1 dhe 2 të këtij neni 79, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

**Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë.**

**KRYETARI**

**MARK BABANI**

